



Prishtinë: 29 dhjetor 2009
Kodi i ZRRE-së: V_216_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh,

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në nenin 15, 26 dhe 31 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare; dhe
4. Aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike të bërë me datë 03.12.2009 nga ndërmarrja "GEN-I Tirana Sh.p.k", adresa: Ish-Noli Business Center, Rruga Ismail Qemali, nr.27, Tiranë, Shqipëri.

Në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2009 nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LËSHOHET** ndërmarrjes "GEN-I Tirana Sh.p.k" licenca për furnizim/tregti me energji elektrike-aktivitet tregtie në Kosovë, për periudhën nga data 29.12.2009 deri 29.12.2011.

Arsyetim

1. ZRRE me datë 03.12.2009 ka pranuar me postë të rregullt aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike nga ndërmarrja "GEN-I Tirana Sh.p.k".
2. Kjo zyrë ka vlerësuar aplikacionin e kompanisë në fjalë, dhe ka kërkuar plotësimin e dokumenteve që mungonin apo nuk përkonin me ato që kërkoheshin në Aplikacion.
3. Pas plotësimit të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
4. Nëse i Licencuari - "GEN-I Tirana Sh.p.k", dëshiron të zhvillojë edhe aktivitete të **furnizimit** me energji elektrike, të përcaktuara në Nenin 4 të licencës, ai duhet të ri aplikojë, duke plotësuar kushtet që nevojitet për këtë aktivitet, sipas udhëzimeve të ZRRE-së.
5. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
6. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda (14) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar